



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 19 nëntor 2015
Nr. ref.: RK 860/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI86/15

Parashtrues

Armond Morina

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
E. Rev. nr. 57/2014, të 17 nëntorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Armond Morina me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 57/2014, i 17 nëntorit 2014, me të cilin Gjykata Supreme e refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit.
3. Ky Aktvendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 26 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin, pretendohet të jetë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR. KI86/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI86/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
8. Më 17 gusht 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 14 tetor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës është pronar dhe drejtor i shtëpisë filmike "Morina Films".
11. Parashtruesi i kërkesës, përkatësisht shtëpia e tij filmike, në vitin 2006, nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: MKRS) ka kërkuar ndihmë financiare për realizimin e projektit filmik "Mysafir në sofër".

12. Më 19 shtator 2008, MKRS-ja ka nënshkruar kontratë me parashtruesin e kërkesës. Në bazë të kësaj kontrate, MKRS-ja, si donator, u zotua për të subvencionuar projektin filmik *"Mysafir në sofër"*.
13. Më 20 tetor 2008, MKRS-ja i transferoi mjetet financiare të dedikuara për realizimin e fazës së parë të projektit filmik *"Mysafir në sofër"*.
14. Më 27 gusht 2010, MKRS-ja e informoi parashtruesin e kërkesës se në bazë të dhënave të marra nga auditimi i MKRS-së, si dhe nga raporti i komisionit të MKRS-së, ishte konstatuar se mjetet financiare të miratuara për realizimin e projektit filmik *"Mysafir në sofër"* nuk janë shpenzuar në pajtim me kontratën, dhe si rrjedhojë e pezullon financimin e mëtejshëm të këtij projekti dhe kërkon nga parashtruesi që t'i kthejë mjetet financiare në buxhetin e Kosovës, të cilat paraprakisht ishin paguar për realizimin e fazës së parë të këtij projekti.
15. Pasi që njoftimi i lartcekur i është dorëzuar parashtruesit, MKRS-ja ka paraqitur padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me kërkesëpadi që parashtruesi (Morina Films) t'i kthejë mjetet financiare, të marra për realizimin e fazës së parë të projektit filmik *"Mysafir në sofër"*.
16. Më 28 shkurt 2012, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë [Aktgjykimi II. C. nr. 13/2011] e miratoi si të bazuar, kërkesën e MKRS-së dhe e obligoi parashtruesin e kërkesës që MKRS-së t'ia kthejë mjetet e fituara financiare, duke përfshirë kamatën e përcaktuar ligjore dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.
17. Më 21 maj 2012, parashtruesi i kërkesës, i pakënaqur me Aktgjykimin e lartcekur ushtroi ankesë në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.
18. Më 22 gusht 2012, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë e refuzoi, ankesën e parashtruesit të kërkesës, si të paafatshme.
19. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
20. Më 20 shtator 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë. Kjo kërkesë është regjistruar me numrin e regjistrimit KI16/13.
21. Më 16 prill 2013, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që të pezullojë procedurën në Rastin KI16/13 deri në vendimin përfundimtar të gjykatave të rregullta.
22. Më 14 qershor 2014, Gjykata merr vendim për heqjen nga lista KI16/13, duke marrë parasysh që në rrethanat e lartcekura, nuk kishte gjetur ndonjë arsye për të vendosur përkitazi me kërkesën.
23. Më 18 korrik 2014, Gjykata e Apelit [Aktvendimi Ae. nr. 412/2012] e refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

24. I pakënaqur me vendimin e Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës ushtroi revizion në Gjykatën Supreme.
25. Më 17 nëntor 2014, Gjykata Supreme [Aktvendimi E. Rev. nr. 57/2014] e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
27. Parashtruesi kërkon nga Gjykata:

“Anulimi i vendimeve të gjykatave, respektivisht Gjykatës Supreme dhe kthimin e çështjes juridike për rigjykim dhe rivendosje për shkak të shkeljeve të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë [...]”.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Para së gjithash, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës.

Neni 48 i Ligjit

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Rregulli 36 i Rregullores së punës

“[...] (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

*[...] (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.
(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

30. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut janë marrë në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

31. Në fakt, parashtruesi i kërkesës pretendon, në përgjithësi, duke iu referuar vendimeve të gjykatave të rregullta, se nuk i ishte ofruar “*gjykim i drejtë dhe i paanshëm*” në gjykatat e rregullta.
32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë arsytim procedural ose material në kërkesën e tij. Ai vetëm përmend nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, pa dhënë sqarime të mëtejshme se si erdhi deri te shkeljet.
33. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Ekonomike e Qarkut e refuzoi ankesën e parashtruesit kundër aktgjykimit të shkallës së parë, duke konsideruar se afati për paraqitjen e ankesës së tillë kishte skaduar. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.
34. Gjykata, gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit e ka arsyetuar aktvendimin e saj në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës: “*Për faktin se aktgjykimi C. nr. 13/11 i datës 28.02.2012, është pranuar nga i autorizuari i të paditurit me datën 11.05.2012, ndërsa ankesa është ushtruar me datën 21.05.2012, pas skadimit të afatit prej 7 ditëve, të paraparë me nenin 509.1 nen c) të LPK, Gjykata e Apelit e Kosovës, gjen se me aktvendimin e atakuar nuk është shkelur ligji në dëm të paditurës dhe se i njëjti është i drejtë dhe i bazuar në ligj*”, duke vërtetuar se Gjykata Ekonomike e Qarkut drejt ka zbatuar të drejtën materiale, kur e refuzoi ankesën e parashtruesit kundër aktgjykimit të shkallës së parë.
35. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion, si të pabazuar, dhe në tërësi e mbështeti arsyetimin e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës së Apelit.
36. Gjykata konsideron se procedurat para Gjykatës së Qarkut, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme ishin të drejta dhe se vendimet ishin në detaje të arsyetuara dhe justifikuara.
37. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konkludon, se procedurat në përgjithësi, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut të 10 korrikut 1991, dhe, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, vendimi i 30 qershorit 2009).
38. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar saktësisht si dhe pse vendimet e kontestuara përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, dhe as nuk ka paraqitur prova për ta arsyetuar pretendimin për një shkelje të tillë.
39. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga autoritete publike, përveç nëse ato kanë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

40. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta ose nga autoritet tjera publike. Roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve të tjera publike është, aty ku është e mundur, t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih gjithashtu: Gjykata Kushtetuese në Rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).
41. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij në bazë të Kushtetutës (Shih *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si neni i Kushtetutës dhe neni i KEDNJ-së, në të cilët ai ishte referuar, e mbështesin pretendimin e tij, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
42. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm janë të pabazuara, nuk janë provuar, dhe rrjedhimisht, janë qartazi të pabazuara.
43. Në bazë të arsyeve të lartcekura, Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 korrik 2015, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Robert Carolan




Arta Rama - Hajrizi